

Akt Themelimi

I Shoqërisë Tregtare “GBARDHAJ 20” Sh.p.k.

Sot më datën 01.12.2020, mbështetur në Kushtetutën dhe Kodin Civil në Fuqi të Republikës së Shqipërisë, në ligjin Nr.7512 datë 10.08.1991 “ Për sanksionimin dhe mbrojtjen e pronës private, nismës së lirë dhe të veprimtarisë private dhe privatizimit”, të ligjit Nr. 9901 datë 14.04.2008, “Për shoqëritë tregëtare” dhe të ligjit Nr.9723, datë 03.05.2007 “Për Q.K.R” dhe formalitetet që duhen respektuar nga Shoqëritë Tregëtare, me vullnet të lirë, të shprehur edhe në nenshkrimin e këtij akt-themelimi, unë ortakut themelues :

- **GËZIM BARDHAJ**, i datelindjes 20.07.1969, lindur në Kuç, Vlorë, banues lagja “Hajro Çakërri”, Vlorë.

krijon shoqërine tregtare “GBardhaj 20” Sh.p.k, Person Juridik, me akt themelimi si vijon :

Formulimi

Neni 1

Formohet Shoqëria Tregëtare private e quajtur “GBardhaj 20” Sh.p.k. Person Juridik. Shoqëria do t’i nënshtrohet legjislacionit Shqiptar. Shoqëria do të ushtrojë veprimtarine e saj në bazë të këtij akti themelues dhe statutit të shoqërisë që do të miratohet nga ortakët themelues .

Selia e Shoqërisë

Neni 2

Selia e shoqërisë tregtare private “GBardhaj 20” Sh.p.k., Person Juridik ndodhet në adresën: Vlorë, Sarandë, Lagja Nr 1, rruga “Turizem – Kanali i Çukës”, km 3-të.

Shoqëria mund të ndryshojë selinë e saj, të hap zyra përfaqësie, dege, brenda Republikës së Shqipërisë me vendim të asamblesë së ortakëve.

Objektivi i Veprimtarisë

Neni 3

Shoqëria do të kryejë aktivitetin e mëposhtëm:
Investitor për Ndërtim dhe shitje të banesave.

Kohëzgjatja e Shoqërisë

Neni 4

Kohëzgjatja e shoqërisë do të jetë 20 vjet. Jetëgjatësia e shoqërisë mund të zgjatet me vendim të Asamblesë së Ortakëve (Ortakut i vetëm).

Kapitali i Shoqërisë

Neni 5

Kapitali fillestar i shoqërisë private “GBardhaj 20” Sh.p.k., Person Juridik do të jetë 100,000 (Njëqind mijë) lekë dhe përbëhet nga kuota, të ndara si më poshtë:

1. **Gëzim Bardhaj**, kontribuon me 100,000 lekë ose zotëron vetëm një kuotë 100 % të kapitalit themeltar.

Kapitali i shoqërisë është nënshkruar dhe shlyer plotësisht.

Drejtimi i Shoqërisë

Neni 6

Gëzim Bardhaj

Shoqëria do të drejtohet nga administratori i saj dhe përfaqësuesi ligjor i saj. Administrator i shoqërisë "GBardhaj 20" Sh.p.k., Person Juridik, emërohet Gëzim Bardhaj. Ai është përfaqësuesi i Shoqërisë në marrëdhënie me të tretët dhe ka kompetenca të plota në drejtimin e saj. Cdo kontratë do të kryhet prej tij dhe ne rast mungese nga një përfaqësues i pajisur me prokurë të posacme.

Neni 7

Të ardhurat neto të shoqërisë u takojnë ortakëve të saj sipas kuotave të zotërimit të kapitalit të shoqërisë: ortaku themelues **Gëzim Bardhaj** zotëron vetëm një kuotë 100%.

Neni 8

Shoqëria ka vulën e saj me madhësi të zakonshme, me tekstin rreth saj .

Neni 9

Shoqëria deklarohet e krijuar në zbatim të plotë të normave të statutit dhe në përputhje me legjislacionin Shqiptar në fuqi dhe vecanërisht të Ligjit Nr.9901 datë 14.04.2008 "Për Krijimin e Shoqërive Tregtare", si dhe duke zbatuar ligjëshmërinë si dhe rregullat që zbatohen për biznesin që kryen kjo shoqëri.

Neni 10

Akti i themelimit u perpilua ne 2 kopje , per tju shperndare organeve kompetente dhe një kopje do te mbetet në dokumentacionin bazë të shoqërisë "GBARDHAJ 20" Sh.p.k., Person Juridik

Akti i themelimit nënshkruhet rregullisht nga ortaku themelues.

Emri dhe nënshkrimet e ortakut themelues:

GËZIM BARDHAJ

